



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 94, datë 20.02.2024

**PËR
KOMANDIMIN E ZNJ. {...}
NË POZICIONIN PEDAGOG I BRENDSHËM, NË SHKOLLËN E
MAGJISTRATURËS**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 659, datë 02.11.2023 për “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”, mbi kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, dërguar me Shkresën nr.6264/1 prot., datë 30.01.2024, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin “Pedagoge e Brendshme” në Shkollën e Magjistraturës.
2. Afati i komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon menjëherë.
3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.
4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Shkollës së Magjistraturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR